

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Sot me date 18/04/2023 une i nenshkruari **Themistokli Nako** lindur me 01/08/1983 ne Qytetin e Lushnjes i identifikuar me karte identiteti me nr 036627322 ID I30801123J Ne baze te ligjit 9901 date 14/04/2008 "per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" dhe ligjit 9723 date 03/05/2007 per QKR. Kam vendosur te themeloj shoqerine tregtare SH.P.K te emertuar **LU-NA AGRO**. Duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i saj do te rregullohet nga statuti i saj i cili do te jete pjese perberese e ketij kti themelimi

Neni 1- Emertimi i shoqerise

Shoqeria eshte person juridik I te drejtes shqiptare, **SHOQERI ME PERGJEJEJSI TE KUFIZUAR**. (me poshte e quajtur "SHOQERIA")

Neni 2 - Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **LU-NA AGRO** sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Paketim te produkteve pleherues.

Neni 3 – Selia

Shoqëria e ka selinë ne Qytetin Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, godina nr 4, ish-SMT, zona kadastrale 8571.

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakeve te kesaj shoqerie.

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi dhe jashte saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Neni 4- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete pa afat, duke filluar prej dates se rregjistrimit te saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit.Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here, me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5 – Kapitali aksionar

Kapitali aksionar do te jete 500 000 (njqind mije) leke. I ndare ne 1 kuota me vlere dhe ne zoterim si me poshte :



1. Themistokli Nako, 1 kuote me vlere 500 000 (peseqind mije) leke

Zoterues i vetem i kesaj kuote Themistokli Nako, e shprehur ne perqindje 100%

Neni 6- Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje ose disa administrator, qofshin keta dhe jo ortak, te cilet emerohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qendrojne ne postin e tyre per pese vjet financiare, me mundesine per tu rizgjedhur.

Administratori/et kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet, ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, ne te gjitha rrethanat qe kane lidhje me objektin e Shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji apo statuti ja jep Asamblese se Ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte Z. **Themistokli Nako** per nje afat 5 (pese) vjecar .Ajo do te ndjeke te gjitha procedurat e nevojshme per rregjistrimin e shoqerise ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit(QKR).

Te gjitha shpenzimet qe do te kryen deri ne rregjistrimin e shoqerise si person juridik do te perfshihen ne bilancin e shoqerise.

Neni 7- Ekspertet Kontabel te Autorizuar.

Shoqeria do te kontrollohet nga nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar. Ne caktimin e eksperteve kontabel te autorizuar mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtushmerite e percaktuara nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Eksperti/et kontabel te autorizuar emerohen nga asambleja e pergjithshme,ne afatet e parashikuara nga ligji, me te drejte rizgjedhje ne kushtet e marrjes se vendimeve qe kerkojne ne shumice te zakonshme.

Detyrimet dhe te drejttat e Eksperteve Kontabel te Autorizuar te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Raportet qe ata pergatisin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

Neni 8- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar, prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit, dhe perfundon ne 31 dhjetor te te njejtit vit.

Pasqyrat financiare,raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme ne kushtet e marrjes se vendimeve qe kerkojne ne shumice te zakonshme.

Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 9 - Dispozita te pergjitheshme

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe u miratua nen per nen nga aksioneri themelues dhe u nenshkrua ne cdo flete me emer mbiemer dhe nenshkrim me vullnet te lire

ORTAKU THEMELUES

Themistokli Nako

Themistokli Nako
TN